




Komuna Skenderaj

Opština Skenderaj

Municipality of Skenderaj



Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural

Direkcija za Poljoprivredu Šumarstvo i Ruralni Razvoj

Department of Agriculture Forestry and Rural Development

DATË/A:	19.08.2024
PËR/ZA/TO	Për fermerët e Komunës së Skenderajt
Njoftim	Zyrës së Kryetarit të Komunës së Skenderaj z. Fadil Nura
NGA/OD/FROM:	Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural z. Behxhet Maliqi
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Thirrje për trajnim në bashkëpunim me Organizata për Ushqim dhe Bujqësi e Kombeve të Bashkuara (FAO) në bashkëpunim me UN Women dhe i financuar nga Agjencia Austriake për Zhvillim (ADC),

Mundësi për trajnim: **Praktikat moderne dhe të qëndrueshme bujqësore dhe ekonomike për “Promovimin e Fuqizimit të Grave Rurale në Kosovë”**

Drejtoria për Bujqësi dhe Zhvillim Rural në komunën e Skënderaj në kuadër të projektit “Promovimi i Fuqizimit të Grave Rurale në Kosovë”, shpall thirrjen për ndjekjen e trajnimeve në fushën e bujqësisë. Projekti i zbatuar nga Organizata për Ushqim dhe Bujqësi e Kombeve të Bashkuara (FAO) në bashkëpunim me UN Women dhe i financuar nga Agjencia Austriake për Zhvillim (ADC), synonë të adresojë barrierat strukturore që pengojnë fuqizimin ekonomik të gruas rurale në sistemet agroushqimore në Kosovë.

Gratë pjesëmarrëse nga Skënderaj do të përmirësojnë aftësitë dhe njohuritë e tyre në teknikat moderne bujqësore, praktikat më të mira ekonomike dhe planifikimin efektiv të biznesit.

Përfitimet nga ky trajnim:

- Mësoni teknikat e avancuara të bujqësisë së menqur dhe të qëndrueshme ndaj ndryshimeve klimatike dhe praktikat më të mira për të përmirësuar produktivitetin dhe qëndrueshmërinë e bizneseve të drejtuara nga gratë ose për të krijuar një agrobiznes të ri.
- Përmirësimi i njohurive për menaxhimin financiar dhe strategjitë e marketingut për të rritur përpjekjet e qëndrueshme të agrobiznesit.
- Udhëzime nga ekspertët për të krijuar një plan biznesi të detajuar, të zbatueshëm, të përshtatur me nevojat dhe objektivat tuaja specifike.
- Bashkëpunimi ekspertë të industrisë dhe gra të tjera rurale për të shkëmbyer njohuri dhe përvoja.

Thirrja për trajnim është e hapur për:

- Gra që aktualisht janë të angazhuara në bujqësi, prodhim, përpunim dhe aktivitete tjera
- Gra që operojnë biznese të vogla në sektorin agro-ushqimor
- Gra, veçanërisht vajza të reja që planifikojnë të fillojnë një biznes të ri në fushën e bujqësisë

Si të aplikoni:

Për të aplikuar për program të trajnimit, ju lutemi plotësoni një formular të shkurtër aplikim të disponueshëm në zyrën e Drejtorit të Bujqësisë. Afati i fundit për dorëzimin e aplikimit tuaj është nga data 19 – 26 gusht 2024.